AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

# NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#12

## Miratohen anëtarët e Këshillit Koordininativ të Diasporës Shqiptare




U miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 195 datë 05.05.2019. Në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë, gjatë muajve të fundit u zhvillua procesi i mbledhjes së kandidaturave për Këshilin Koordinues të Diasporës Shqiptare.

Procedura e përzgjedhjes u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 16/2018 "Për Diasporën" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 340, Datë 06.06.2018, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës".

Numrit të madh të kandidaturave të mbledhura nga shumë vende të botës ju nënshtrua një proces konsultimi i cili u përmbyll me Samitin e Dytë të Diasporës Shqiptare.

https://diaspora.gov.al/miratohen-anetaret-e-keshilli-te-koordinimit-te-diaspores-shqiptare/

## Miratohet vendimi për kthimin e fondit të papërdorur për Samitin e Diasporës, në buxhetin e shtetit




Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për kthimin në buxhetin e shtetit, të fondit të pa përdorur (kursyer) nga buxheti i caktuar për realizmin e Samitit të Dytë të Diasporës. Sipas këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare e cila menaxhoi fondet për Samitin e Dytë të Diasporës Shqiptare do të kthejë në buxhetin e shtetit, shumën prej 14 561 598 (katërmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lek…

https://diaspora.gov.al/miratohet-nga-keshilli-i-ministrave-vendimi-per-kthimin-e-fondit-te-paperdorur-per-samitin-e-diaspores-ne-buxhetin-e-shtetit/

## Ministri takohet me diplomatët e rinj të Akademisë Diplomatike






## Publikohet Buletini tre mujor për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës

Publikohet Buletini tre mujor për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2018 – 2024.
Buletini botohet çdo tre muaj nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. Qëllimi i botimit të Buletinit është informimi i publikut mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 – 2024 nga institucionet përgjegjëse në tremujorin e parë të vitit.
Ai është publikimi i katërt i këtij lloji.

Ky dokument përmban:
Të dhënat që pamasat e Planit të Veprimit të cilat janë në procesin e zbatimit,raqet ky publikim informojnë publikun dhe anëtarët e strukturave vendimmarrëse për ecurinë e politikës shtetërore për Diasporën.

https://diaspora.gov.al/publikohet-buletini-tre-mujor-per-ecurine-e-zbatimit-te-masave-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-strategjise-kombetare-te-diaspores/

## Agjencia Kombëtare e Diasporës merr pjesë në Panairin e Turizmit Ndërkombëtar Tirana 2019

Agjencia Kombëtare e Diasporës merr pjesë në Panairin e Turizmit Ndërkombëtar Tirana 2019 i cili po zhvillohet në ambientet e "Expo City". Ky panair, pjesë e Programit Shtetëror të Aktiviteteve për Diasporën, është i publikuar në faqen elektronike të Agjencisë, ku çdokush mund të informohet dhe të vendos në axhendën personale pjesëmarrjen në aktivitete që iu përgjigjen interesave apo distancës nga vendbanimi i tyre…

https://www.facebook.com/pandelimajkodiaspora/photos/pcb.682110258934748/682109978934776/?type=3&theater



